



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.1029/13

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në kontestin e paditësit S. P. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson F. Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës K. E. e K. (K.), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson O. K. nga Prishtina, me objekt të padisë anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në prezencë të palëve, me datë **25.03.2014** mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit S. P. nga Prizreni.
- II. ANULOHEN si të kundërligjshme** njoftim-vendimi i të paditurës me nr.493/1, datë 01.04.2010, i nxjerr nga K. sh.a D. i F. D. Prizren, me të cilin paditësit S. P. i është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe vendimi i K. sh.a D. i Rr. 01 në Prishtinë me nr.106 datë 26.04.2010, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit, e parashtruar kundër njoftim-vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
- III. DETYROHET** e paditura K. E. e K. (K.) me seli në Prishtinë, që ta kthejë paditësin në vendin e tij të punës, në detyrat e punës specialist i daljeve në D. e F.-D. i Prizrenit, apo në ndonjë vend tjetër të punës në përputhje me kualifikimet që ka paditësi, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- IV. DETYROHET** e paditura K. me seli në Prishtinë që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 714 €, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur pranë pohimeve të padisë dhe kërkesëpadisë dhe deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, duke shtuar se tani e precizon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke kërkuar nga gjykata që ti anuloj vendimet, me të cilat i është ndërprerë puna paditësit dhe të detyrojë të paditurën që të njëjtin ta kthejë në vendin e tij të punës specialist i daljeve në Divizionin e Furnizimit-Distrikti i Prizrenit, ndërsa për sa i përket

realizimit të të ardhurave personale, deklaroi se paditësi e rezervon të drejtën që pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se e paditura nuk i paguan vullnetarisht të ardhurat personale, atëherë paditësi do të parashtrijë padi të re për këtë çështje. Më tutje ka shtuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar te e paditura në vendin e punës specialist i daljeve në Divizionin e Furnizimit-Distriktit të Prizrenit. Me njoftimin e të paditurës nr.493/1 të dt.01.04.2010, paditësit i shkëputet kontrata e punës, për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, të parapara me nenin 11 pika ë1, ç,11.4 pika b të Rregullores 2001/27 të Ligjit Themelor të Punës dhe nenit 8.1, 8.2 dhe 8.3 të rregullores nr.3 për Operacionet e Distrikteve të K., në mënyrë që kinse paditësi nuk ka realizuar performancën për muajin dhjetor 2009, janar dhe shkurt 2010. Kundër këtij vendimi paditësi ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.02.04.2010, të cilën drejtori i Divizionit të Furnizimit e ka refuzuar si të pabazuar me vendimin nr.106 të dt.26.04.2010 pa kurrfarë arsytimi. Më tutje ka theksuar se njoftim-vendimi i të paditurës për shkëputjen e marrëdhënies së punës nuk është i ligjshëm dhe është në kundërshtim me ligjin themelor të punës dhe rregulloren nr.3 të K., sepse paditësi gjatë takimit me menaxherin e Distriktit me dt.02.04.2010 ka prezantuar faktet që vërtetojnë se i njëjti i ka kryer obligimet sipas realizimit në fund të muajve 2009 deri në muajin mars 2010. Gjithashtu ka shtuar se me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës e paditura nuk ka inicuar dhe mbajtur procedurë disiplinore ndaj paditësit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenet 111 dhe 112 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës (i aplikueshëm në Kosovës deri me hyrjen në fuqi të ligjit të Punës), me të cilat dispozita janë paraparë edhe afatet për fillimin dhe përfundimin e kësaj procedure (më gjerësisht referoju fjalës përfundimtare të të autorizuari të paditësit). Si rrjedhojë ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit dhe vlerësimit të provave të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për padi, shqyrtimet e mbajtura, për ankesë, për revizion dhe për ekspertizë.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen e vet ndaj pohimeve të padisë dhe kërkesë padisë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes së dhënë në padi dhe deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, përmes së cilës e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se një kërkesë e tillë është e pabazë, për faktin se e paditura ka vepruar në harmoni me ligjin kur paditësit ia ka shkëputur kontratën e punës, përmes njoftimit nr.493/1 dt.01.04.2010. Më tutje ka theksuar se në procedurën e zhvilluar te e paditura në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se paditësit i është shkëputur kontrata e punës për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës të parapara me nenin 11.1 (ç), 11.4 (b) të rregullores për Ligjin Themelor të Punës, rezultateve të pakënaqshme në punë nga neni 8.1, 8.2.8.3 (c) të Rregullores nr.3 për Operacionet e Distrikteve të K., në atë mënyrë që nuk e ka realizuar performancën për tre muajin e fundit dhe atë dhjetor 2009, janar dhe shkurt 2010. E gjithë kjo ka rezultuar nga mos përmbushja e detyrave të punës edhe më parë, më saktësisht në muajin tetor 2009 i njëjti nuk ka realizuar objektivin e përcaktuar dhe për këtë i shqiptohet masa disiplinore nr.1247 dt.22.10.2009 vërejtje e fundit me shkrim. Në vërejtjen e fundit me shkrim i është bërë me dije paditësit se çfarëdo rasti tjetër i rezultateve të pakënaqshme në punë apo shkeljeve tjera do të përbëjë bazën për shkëputje të kontratës së punës. Paditësi ka vazhduar të përsërisë rezultatet e dobëta në punë edhe për tre muajin e lartcekur dhe për këtë e paditura i ka shkëputur kontratën e punës. Më tutje ka theksuar se shkëputja e kontratës së punës për shkak të përmbushjes së

pakënaqshme të detyrave të punës është bërë bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/27, i cili përcakton se në rastin e tillë shkëputja e kontratës së punës bëhet pa procedurë paraprake dhe disiplinore, vetëm me njoftim, andaj e paditura drejtë ka vepruar kur paditësit i ka shkëputur kontratën e punës. Më tutje ka shtuar se pala e paditur ka vërejtje në raportin e ekspertit të elektroteknikës, ndërsa ka theksuar se edhe në riprocedurë pas ekspertizës së ekspertit të cekur më lartë është vërtetuar e njëjta performancë e paditësit, andaj konsideron se tani janë evituar të gjitha të metat e cekura nga Gjykata Supreme, për të refuzuar kërkesëpadnë e paditësit (më gjerësisht referoju procesverbalit të datës 25.03.2014). Si rrjedhojë ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit dhe vlerësimit të provave ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës deklaroi se nuk i kërkon.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e këtyre provave: vërejtjen e fundit me shkrim nr.1247 dt.22.10.2009, ftesën për takim të menaxherit të Distriktit nr.487 dt.31.03.2010, procesverbalin mbi takimin e menaxherit të distriktit me paditësin nr.493 dt.01.04.2010, njoftimin mbi shkëputjen e kontratës së punës nr.493/1 dt.01.04.2010, kërkesën për rishqyrtimin e njoftimit të sipërpërmendur, vendimin e Divizionit të Furnizimit të të paditurës nr.106 dt. 26.04.2010, përkshkrimin e detyrave të punës për paditësin, rregulloren nr.3 të K., raportin për verifikimin e performances për paditësin në periudhën dhjetor 2009, janar dhe shkurt 2010 i dt.01.03.2010, kartelën e punës së paditësit, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit V. S., ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës M. Gj., datës 10.02.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse, provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe udhëzimeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktvendimin Rev.nr.170/2013, datë 27.09.2013, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Meqenëse për palët ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese faktet që kanë të bëjnë me punësimin e paditësit tek e paditura deri në kohën kur të njëjtit i shkëputet kontrata e punës nga e paditura (ka qenë me kontratë pune në kohë të pa caktuar), gjykata nuk e pa të nevojshme të provojë faktet për këtë çështje.

Kontestuese për palët ndërgjyqëse ishte çështja e ligjshmërisë së vendimit të të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës paditësit, çështja se e paditura këtë vendim a e ka marr në përputhje me dispozitat ligjore të parapara në ligjin themelor të punës të shpallur me rregulloren nr.2001/27, ligjet që kanë qenë në fuqi deri me datë 16 dhjetor 2010 (Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 dhe Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977) dhe rregulloren nr.3 të K., si dhe ky vendim a është i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Pas vlerësimit të provave të administruara, të ofruara nga palët ndërgjyqëse të cilat nuk ishin kontestuese, gjykatës i rezultoi se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar të e paditura, i caktuar në vendin e punës specialist i daljeve në Divizionin e Furnizimit. Me njoftimin e të paditurës

nr.493/1 të dt.01.04.2010, paditësit i shkëputet kontrata e punës, për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës të parapara me nenin 11.1 (ç), 11.4 (b) të Ligjit Themelor të Punës, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27 (ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësit i është shkëputur kontrata e punës), rezultateve të pakënaqshme në punë nga neni 8.1, 8.2.8.3 (c) të Rregullores nr.3 për Operacionet e Distrikteve të K., me arsyetim se paditësi nuk ka realizuar performancën për muajin dhjetor 2009, janar dhe shkurt 2010. Kundër njoftim-vendimit për shkëputje të kontratës së punës paditësi ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.01.04.2010, të cilën udhëheqësi i Divizionit të Furnizimit të të paditurës e refuzon si të pabazuar me vendimin nr.106 të dt.26.04.2010. Para shkëputjes së kontratës së punës, menaxheri i Distriktit të K. në Prizren, me dt.08.06.2010, ka mbajtur një takim me paditësin për ti shpjeguar arsyet e shkëputjes së kontratës së punës. Dhe së fundmi pas marrjes së përgjigjes negative nga udhëheqësi i Divizionit të Furnizimit, paditësi ushtron padi në gjykatë ku kërkon anulimin e vendimeve të të paditurës dhe kthimin në vendin e punës.

Gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin kryesor V. S. përndryshe Menaxher i Distrikti të Prizrenit, të cilës dëshmi gjykata nuk ja fali besimin për shkak se i njëjti i ka ndërprerë kontratën e punës paditësit dhe në këtë rast dëshmia e tij ishte e njëanshme dhe kundërthënëse, ka deklaruar se shkëputja e kontratës së punës paditësit është bërë në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Themelor të Punës dhe Rregullores nr.3 të K., për shkak se paditësi gjatë tre muajorit kontestues (dhjetor 2009, janar dhe shkurt 2010) ka treguar performancë të dobët në punë. Kjo për faktin se për muajin dhjetor 2009 performanca e paditësit ka qenë 57.9 %, ndërsa linja 0 69%, për muajin janar 2010 linja 0 ka qenë 63%, ndërsa rezultati 43.8 %, për muajin shkurt 2010 linja 0 ka qenë 63%, ndërsa rezultati 53.7 %. Më tutje ka deklaruar se paditësi edhe më herët ka pasur vërejtje me shkrim për shkak të mospërmbushjes së detyrave të punës, nga ana e K. në Prishtinë. Dëshmitari gjatë dëshmisë së tij ka sqaruar edhe faktin se çka hynë në performancën e një punëtori, ku sipas tij në performancë hyn: kodi i etikës dhe i mirësjelljes, leximi i saktë i njehsorëve elektrik, shpërndarja e faturave, bllobimi i njehsorëve, ç'kyçja e konsumatorëve për borxh etj.

Në ekspertizën e ekspertit M. Gj. inxhinier i elektroteknikës, ndër të tjera konstatohet se performanca grupore e paditësit në inkasim/faturim për muajin dhjetor 2009 ka qenë 75.06 %, realizim i çkyqjeve 158.46 %, për muajin janar 2010 inkasim/faturim është 58.96%, ndërsa realizim i çkyqjeve 105.81 % dhe për muajin shkurt 2010 inkasim/faturim 104.63%, ndërsa realizimi i çkyqjeve 149.32 %. Në mendimin e tij përfundimtar eksperti M. Gj. konstaton se performancat e inkasim faturimit dhe realizimit të çkyqjeve tregon se grupi vazhdimisht ka qenë i angazhuar në realizimin e detyrave, ku edhe shihet realizimi në % mesatarisht 79.01 % dhe realizimi i çkyqjeve mesatarisht për tre muaj është 139.18 %, mirëpo rrjeti i vjetëruar, keqpërdorimet, kyçjet ilegale, si dhe humbjet teknike, komerciale e vështirësojnë realizimin e performancave në inkasim/konsum, ku përgjegjësia është më e gjerë dhe nuk mund të fajësohen vetëm specialistët e daljeve. Eksperti në fjalë ka dhënë edhe sqarime gojore në lidhje me ekspertizën e përmendur më lartë në shqyrtimin kryesor të datës 25.03.2014.

Nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se vendimet e të paditurës për ndërprerjen e kontratës së punës paditësit janë të paligjshme, pasi që deri te kjo

ndërprerje ka ardhur pa u verifikuar saktësisht dhe plotësisht performanca individuale e treguar gjatë punës së tij nga paditësi, por vetëm performanca grupore, e cila edhe është llogaritur në mënyrë jo të drejtë. Si rrjedhojë, gjykata ka vlerësuar performancën grupore të paditësit të treguar në tre muajt kontestues, bazuar në ekspertizën e eksperti M. Gj., të cilës ja fali besimin e plotë, pasi e njëjta ishte e plotë, e saktë dhe në përputhje me provat tjera materiale, ndërsa në shqyrtimin kryesor eksperti shpjegoi detalisht vështirësitë e sezonit dimëror në realizimin e objektivave të punës. Andaj, në bazë të vlerësimit të ekspertit të lartcekur, performanca e paditësit (grupore) për tre muajt kontestues ka qenë 79.01 % (mesatarisht për këta tre muajt) e jo 57.9 %, 43.8 % apo 53.7 % (për tre muajt kontestues) siç e ka cekur e paditura, ndërsa realizimi i çkyqjeve ka qenë 139.18 % për tre muajt kontestues (mesatarja). Si rrjedhojë, gjykatës i rezultoi se e paditura nuk e ka bërë vlerësimin real të punës së paditësit dhe për këtë ka pasur si pasojë shkëputjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme. Gjithashtu edhe pretendimin tjetër të të paditurës se paditësit i është ndërprer marrëdhënia e punës ndër të tjera edhe për faktin se me dt.22.10.2009, menaxheri i distriktit i ka shqiptuar vërejtjen e fundit me shkrim nr. 1247, ku i është tërhequr vërejtja që të përmirësojë performancën e tij, pasi në të kundërtën do ti ndërprehet kontrata e punës, gjykata nuk e pranoi, për faktin se kjo vërejtje i është shqiptuar paditësit për shkak të mos respektimit të orarit të punës, e jo decidivisht për shkak të performancës së dobët. Gjykata vlerësoi se ndërprerja e kontratës së punës paditësit nga Menaxheri i Distriktit është bërë në mënyrë të njëanshme gjoja për shkak të performancës së dobët dhe si duket është pritur momenti i sezonit dimëror ku vështirësitë për realizimin e objektivave janë më të mëdha (këto vështirësi i ka elaboruar mjaftë mirë eksperti M. Gj.). Gjykata vlerëson se nga provat të cilat u administruan nuk u konstatua se paditësi ka kryer ndonjë shkelje të detyrave të punës, përkundrazi është vlerësuar puna e tij si profesionale dhe efektive, se i njëjti ka respektuar në tërësi të gjitha rregulloret, udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna nga menaxherët e tij.

Përveç të lartcekurave, gjykata erdhi në përfundim se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, është i kundërligjshëm edhe për shkak se e paditura për shkëputjen e marrëdhënies së punës së paditësit nuk ka inicuar fare procedurë disiplinore, me të cilën eventualisht do të vërtetoheshin shkeljet e detyrave të punës dhe do të shqiptoheshin masat disiplinore adekuate. Kjo procedurë ka qenë e paraparë me legjislacionin në fuqi, me saktësisht në bazë të ligjit për marrëdhënien e punës i KSA të Kosovës, i vitit 1989 dhe ligji i punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977, të cilat ligje kanë qenë të zbatuara në Kosovë në bazë të rregullores së Unmik-ut nr.1999/24 e ndryshuar me rregulloren 2000/59. Nenet 203 dhe 204 të ligjit të Punës të ish Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ 53/76), rregullojnë në tërësi procedurën disiplinore që iniciohet ndaj një punëmarrësi, ndërsa neni 112 dhe 113.2 i ligjit të Punës së Kosovës (Gazeta Zyrtare KSAK nr.12/89, teksti i spastruar, të cilat ligje kanë qenë në fuqi deri në hyrjen e ligjit të ri të punës të Republikës së Kosovës), përcaktojnë që procedura disiplinore duhet të iniciohet nga organet kompetente (komisioni disiplinor) dhe ky organ apo komision duhet të marrë në pyetje punëmarrësin.

Si përfundim, gjyka vlerëson se vendimet e të paditurës për ti shkëputur kontratën e punës paditësit janë të paligjshme, pasi janë marrë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit themelor të punës (Rreg. 2001/27) që ka qenë në fuqi në kohën e ndërprerjen së kontratës së punës dhe ligjeve të përmendura

më lartë (Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSAK i vitit 1989 dhe Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977) që kanë qenë në fuqi deri me datë 16 dhjetor 2010, datë kur ka hyrë në fuqi ligji i punës, si dhe me dispozitat e parapara me Rregulloren nr. 3 të K., andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo siç e cekëm edhe më lartë për shkak të mos inicimit të procedurës disiplinore ndaj paditësit dhe mos dhënien e mundësisë së njëjtit për tu deklaruar në lidhje me pretendimet e të paditurës, të metave formale të cilat i përmban vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të cilat u përmendën më lartë, si dhe për shkak të vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe TA-së, dhe atë 101 € për përpilim të padisë, dhe nga 121 € për 3 përfaqësime në seanca gjyqësore (sipas TA-së së vjetër, pasi në kohën e mbajtjes së këtyre shqyrtimeve ku paditësi është përfaqësuar nga av. D. J., ka qenë në fuqi kjo tarifë), 50 € për ekspertizë, 100 € ankesa si dhe 100 € revizioni, apo gjithsejtë 714 €.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 7 dhe 8, lidhur me nenin 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
C.nr.1029/13 me 25.03.2014

Procesmbajtësja,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.